



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:003422

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05906267

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen kontestimore të paditësve Sh.O., nga Komuna e Shtimes, me numer personal S.S., nga Shtime, me numër personal, M.H. nga Komuna e Shtimes me numër personal të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson avokati Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Shtimes- Drejtoria e Arsimit në Shtime, të cilën e përfaqëson L.M., baza juridike: kompensim për: inflacion, licencim – gradim me datë 07.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve Sh.O., nga Komuna e Shtimes, me numer personal S.S., nga Shtime, me numër personal, M.H. nga Komuna e Shtimes me numër personal ,dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit në Shtime që paditësve Sh.O., nga Komuna e Shtimes, me numer personal S.S., nga Shtime, me numër personal, M.H. nga Komuna e Shtimes me numër personal t'ia paguaj shumat siq vijon :

Paditësit Sh.O. në emër të diferencës së pa paguar në emër të licencimit-gradimit për periudhën kohore 11.01.2019 deri më datë 31.01.2020 shumën prej 307 euro, në emër të inflacionit në pagë nga data 11.01.2019 deri me datën 31.03.2020 shumën prej 133.65 euro, të gjitha këto shuma me kamatë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data 11.01.2022 deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

Paditësit S.S. në emër të diferencës së pa paguar në emër të licencimit-gradimit për periudhën kohore 11.01.2019 deri më datë 31.01.2020 shumën prej 307 euro, në emër të inflacionit në pagë nga data 11.01.2019 deri me datën 31.03.2020 shumën prej 133.65 euro, të

gjitha këto shuma me kamatë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data 01.02.2023 deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

Paditësit M.H. në emër të diferencës së pa paguar në emër të licencimit-gradimit për periudhën kohore 11.01.2019 deri më datë 30.05.2022 shumën prej 779 euro, në emër të inflacionit në pagë nga data 11.01.2019 deri me datën 30.05.2022 shumën prej 541 euro, të gjitha këto shuma me kamatë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data 01.02.2023 deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

II.DETYROHET, e paditura Komuna e Shtimes-Drejtoria e Arsimit në Shtime që paditësve Sh.O., nga Komuna e Shtimes, me numer personal S.S., nga Shtime, me numër personal, M.H. nga Komuna e Shtimes me numër personal në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tua paguaj shumat siq vijon: për hartimin e padis 208 euro, për një seancë gjyqësore 270.40 euro, për taksën gjyqësore për padi 30 euro ,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

III.Detyrohen paditësit Sh.O., nga Komuna e Shtimes, me numer personal S.S., nga Shtime, me numër personal, M.H. nga Komuna e Shtimes me numër personal që kësaj gjykate në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi tia paguaj shumën prej 10 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit Sh.O., nga Komuna e Shtimes, me numer personal S.S., nga Shtime, me numër personal, M.H. nga Komuna e Shtimes me numër personal , kanë parashtruar me padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit me bazë juridike kompensimi për :inflacion,licencim –gradim.

Nga thëniet e paditësve në padi rezulton se të njejtit padinë e bazojnë në faktet e theksuara:se janë punëtorë të të paditurës në vendin e punës mësimdhënës në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët ‘... në Sh.. dhe shkollën Filllore e Mesme e Ulet ‘ , por e paditura nuk ua ka paguar inflacionin në pagë, kompensimin për licencim –gradim edhe pse e drejta

e tillë u takon në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kontratës Kolektive në Arsim.

E paditura Komuna e Shtimës – Drejtoria e Arsimit në Shtime përmes përfaqësuesit të saj L.M. i ka propozuar gjykatës që të refuzohet kërkesëpadia e paditësve në tërësi si e pa bazuar duke theksuar se paditura Komuna e Shtimes nuk ka pasur mjete financiare për të bërë pagesa e kërkuara dhe Ministra e Arsimit nuk i ka ndihmuar me mjete financiare Komunitat për të bërë këto pagesa. Kontrata Kolektive e Arsimit është shkëputur me njoftimin e Ministris së Arsimit nr.01B/488 ,i datës 22.11.2022. ,prandaj nga data 21.11.2022 Kontrata në fjalë nuk është në fuqi. Përveq kësaj kërkesëpadia e paditësve është parashkruar. Nuk janë kontestuese faktet: se paditësit janë punëtorë të të paditurës në. Nuk është kontestuese se kanë punuar në ditët për të cilat kërkojnë kompensim .Nuk është kontestuese lartësia e kërkesëpadis, si dhe licencimi, por kontestuese është baza e kerkese padisë.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga faktet jo kontestuese në mes palëve vërtetohet se paditësit janë punëtorë të të paditurës, e që ky fakt vërtetohet edhe nga Kontrata e Mardhënies së Punës të lidhura në mes paditësve dhe të paditurës të administruara si provë gjatë shqyrtimit kryesorë gjyqësore edhe atë: Kontrata e datës 14.01.2016 ne emër te Sh.O. Kontrata e datës 26.01.2016 ne emër te S.S.; Kontrata e datës 26.01.2016 ne emër te M.H.

Nga faktet jo kontestuese në mes palëve vërtetohet se paditësit kanë licencim por që vërtetohen edhe nga provat si në vijim: Diploma e shkollës Normale e datës 27.08.1975 ne emër te Sh.O., Licenca e datës 10.12.2012 ne emër te Sh.O.; Diploma e datës 08.11.1978 ne emër te S.S.; Diploma e datës 04.12.2008 ne emër te M.H. Licenca e datës 10.12.2012 ne emër te M.H.;

Kurse fakti se e paditura nuk e ka paguar shpërblimin për licencim dhe gradim dhe nuk e ka paguar kompensim për inflacion të kërkuar nga paditësit nuk ishte kontestuese ne mes palëve por një fakt i tillë vërtetohet edhe nga listat e pagave të administruara si provë.

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruara, deklaratat e palëve dhe faktet jo kontestuese në mes tyre vendosi si në dispozitiv edhe atë nga këto arsye :

Me nenin 35 paragrafi të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë,të datës 18.04.2017 është paraparë se për qdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Kosovës dhe përqindja e inflacionit futet në pag.

Kurse me nenin 35 paragrafi të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë,të datës 22.01.2021 është paraparë se për qdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Kosovës dhe përqindja e inflacionit futet në pag.

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33,i datës 29.08.2008 është paraparë kompensimi në bazë të kualifikimit –gradimit : sipas të cilit vendim mësimdhënësit :me diplomë të shkollës normale përfitojnë 10 % ngritje page,mësimdhënësi me diplomë të shkollë të lartë të pedagogjisë përfitojnë ngritje page 19 %,mësimdhënësit me diplomë universitare 3- 4 vite përfitojnë ngritje page 27 % ,mësimdhënësit me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë [Magjistraturë dhe Doktoraturë]përfitojnë ngritje page 35 %

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e sipër përmendura të Kontratave Kolektive Sektoriale, vendimit të sipër përmendur të Qeverisë si dhe gjendjes faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si më lartë, ka nxjerrë përfundim se është bazuar kërkespadia e paditësve dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te paditurën që paditësve t’ua paguaj shumën si në pikën I, dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u nisur nga fakti se nga provat e adminisruara dhe faktet jo kontestuese në mes palëve u vërtetua se paditësit janë punëtorë të të paditurës , kanë punuar në në periudhën kohore për të cilat kërkojnë kompensim, kanë kualifikim dhe licencim ,si dhe nuk është kontestues lartësia e kërkesëpadisë.Si dhe nuk është kontestuese se e paditura paditësve nuk ua ka paguar shumat që i kërkojnë me kërkesëpadi

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e të paditurës e cila e kundërshton kërkesëpadin duke u bazuar në mos sigurim të mjeteve fiannciare ,por këtë theksim gjykata e quan si të pa bazuar edhe atë nga këto arsye :Baza ligjore e kërkesëpadisë së paditësit qëndron edhe në Ligjin për Mardhënjet e Detyrimeve, dispozitat përkatëse të këtij ligji që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, kurse konform nenit 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Kurse me nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së është paraparë Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe kundërshtimin e parashkrimit, por në rastin konkret kërkesëpadia nuk është parashkruar ,sepse paditësit kërkojn kompensim për periudhën nga viti 2019 data 11.01.2019 e tutje ,kurse padin e kanë paraqitur në gjykatë me datë 11.01.2022 kjo nënkupton se padia është paraqitur para kalimit të afatit prej 3 vite dhe nuk kemi parashkrim

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve i Kosovës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Gjyqtari,

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.